



## ANEKS KONTRATA

Date: 08.11.2019

### Në mes të

**Komuna e Podujevës** ( në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

**N.N.T "Bini" Sh.P.K**, adresa **Podujevë** përfaqësuar nga **Afrim Hajdari**, me numër të regjistrimit të biznesit **811318999**, në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate


Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në qytet dhe fshatra** me nr. të prokurimit **615-19-2570-5-2-1**, nr i brendshëm **044** të datës: **26.06.2019**, e cila kontratë është në realizim e sipër

- i. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **Ndërtimi i kanalizimeve fekale në qytet dhe fshatra – punë shtesë**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës **08.11.2019** me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

### ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. **Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: 7,339.30 €**  
(shtatë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë euro e tridhjetë cent sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [61519044521/5] .
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas përfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
  - a. Marrëveshja e kontratës;
  - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
  - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

| Për Autoritetin Kontraktuesin |                                                                                   | Për Kontraktuesin |                                                                                     |
|-------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:                         | Rasim Fejza                                                                       | Emri:             | Afrim Hajdari                                                                       |
| Pozita:                       | menaxher i prokurimit                                                             | Pozita:           | Drejtor                                                                             |
| Nënshkrimi:                   |  | Nënshkrimi:       |  |
| Data:                         | 08.11.2019                                                                        | Data:             | 08.11.2019                                                                          |
| Vula:                         |  | Vula:             |  |